



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLICA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Emri i biznesit: OJQ - Shoqata Radio Maria

Numri i Regjistrimit: 6000882-5

Drejtor: Greta Kaçinari

OSHMA: Radio MARIA

Adresa: Rr/Brigada 123, p.n Suharekë



VENDIM

për ripërtëritjen e licencës të Ofruesit të Shërbimeve Mediale Audio – Radio Maria, me seli në Suharekë

Fakte

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), është organ i pavarur i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit. KPM-ja rregullon të drejtat, detyrimet si dhe përgjegjësitë e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbimet mediale audio dhe audio vizuale.
2. Radio Maria është Ofrues i Shërbimeve Mediale Audio me mbulim lokal, i cili është licencuar nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM), për transmetim tokësor analog të programeve të radios, me seli në Suharekë. KPM, me vendimin e datës 28 gusht 2016, lëshimin e licencës së Radio Maria për një afat prej shtatë (7) vitesh, ndërsa më datën 28 gusht 2023, skadon afati i licencës së Radio Maria
3. Me datën 18 prill 2023, KPM përmes e-mail ju ka dërguar shkresë të gjitha radiove të cilave afti i licencës ju skadon licenca në vitin 2023, në mesin e tyre edhe Radio Maria, përmes së cilës shkresë i ka njoftuar lidhur me skadimin e afatit të licencës dhe mundësin e ripërtëritjes së saj në pajtim me Nenin 25 të Ligji Nr. 04/L-44 për Komision i Pavarur të Mediave.
4. Më datën 28 gusht 2023, Radio Maria ka dorëzuar një kërkesë me shkrim në Zyrën Ekzekutive të KPM-së, përmes së cilës ka kërkuar ripërtëritjen e licencës

Arsyetim

5. Ligji Nr. 04/L-44 për Komision i Pavarur të Mediave, përcakton se KPM është organ i pavarur i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit si dhe rregullon të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbime mediale audio-vizuale.
6. Neni 25 i Ligjit të KPM-së përcakton: *Përveç rasteve kur KPM-ja konsideron se licenca nuk duhet të ripërtëritjet për shkak të shkeljes së dispozitave materiale nga ana e ofruesit të shërbimit medial audio vizual privat për sa u përket kushteve dhe kritereve të licencimit, kandidati ka të drejtë të*

kërkojë përtëritjen e licencës nga Komisioni brenda gjashtë (6) muajve para skadimit të datës së licencës ekzistuese dhe minimum gjashtëdhjetë (60) ditë para skadimit të licencës.

7. Me anë të shkresës së datës 18 prill 2023, lidhur me njoftimin për skadimin e afatit të licencës, KPM gjithashtu, ka njoftuar Radio Maria lidhur me dokumentacionin e nevojshëm për ripërtëritjen e licencës.
8. Komisioni konstaton se, Radio Maria përmes kërkesës me shkrim ka shprehur interesim për vazhdimin e veprimtarisë së ofrimit të shërbimeve mediale audio (radio) në lokacionin për të cilin është licencuar. Radio Maria mos aplikimin me kohë për ri licencim e ka arsyetuar me faktin se në vitin 2022 është ri licencuar Radio Maria me seli në Obiliq, prandaj ka pasur një konfuzion për sa i përket datave për aplikim
9. Komisioni e KPM-së konsideron se nuk janë evidentuar shkelja të tilla të dispozitave materiale të Ligjit dhe akteve nënligjore të KPM-së, nga ana e ofruesit të shërbimit medial, Radio Maria të cilat shkelje do të pamundësonin ripërtëritjen e licencës.
10. Komisioni konstaton se Radio Maria ka shlyer të gjitha obligimet financiare ndaj KPM - së, përfshirë këtu edhe pagesën e tarifës administrative për ripërtëritje të licencës, e paraparë me Rregulloren KPM-2017/06.
11. Komisioni vlerëson se kërkesa për ripërtëritjen e licencës së Radio Maria është dorëzuar në pajtim me dispozitat ligjore të parapara me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së dhe si e tillë kërkesa për ripërtëritjen e licencës së Radio Maria i plotëson kushtet për miratim dhe se ripërtëritja e licencës është në interesin e publikut në zonën në të cilën operon kjo radio.

Vendim

12. Komisioni në takimin e datës 1 shtator 2023, merr vendim për miratimin e kërkesës për ripërtëritjen e licencës për Radio Maria për vazhdimin e veprimtarisë të ofrimit të shërbimeve mediale audio, e cila veprimtari është në interes të publikut në lokacionin për të cilin është licencuar dhe në të cilin është duke transmetuar program Radio Maria.
13. Licenca e Radio Maria do të jetë e vlefshme për një afat prej shtatë (7) vitesh, ashtu siç është përcaktuar me Nenin 21, paragrafin 2, të Ligjit për KPM-në, ndërsa vlefshmëria e afatit të licencës do të llogaritet nga data 28 gusht 2023.
14. Të gjitha parametrat e licencës së Radio Maria, siç janë: kategoria e të licencuarit, skema programore, parametrat teknike dhe harta e zonës së mbulimit do të mbesin të pandryshuar nga licenca paraprake.
15. Këtë vendim e lëshon Komisioni dhe i njëjti hyn në fuqi nga data e nënshkrimit.



Jeton Mehmeti

Kryetar

Komisioni i Pavarur i Mediave



01.09.2023

datë